



01nr 413/01-15079  
Dt: 27.06.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, duke vepruar konform dispozitave të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe të Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, me datën 27.06.2023, merr këtë:

### V E N D I M

1. Shkëputet Kontrata për shfrytëzimin e hapësirës komunale, e lidhur ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe përfaqësuesit të biznesit “Gentleman Tobacco L.L.C” nga Gjakova, me numër 01-413/01-7793, e datës 14.04.2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

### A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës dhe z. Gjergj Dodaj, përfaqësues i biznesit “Gentleman Tobacco” L.L.C nga Gjakova kanë lidhur Kontratë me numër 01-413/01-7793 e datës 14.04.2023, për shfrytëzimin e hapësirës komunale – për terracë të lokalit, në rrugën “Tirana”, me kohëzgjatje nga dita e nënshkrimit të kontratës deri me datën 31.10.2023.

Përfaqësuesi i biznesit “Gentleman Tobacco L.L.C, me kërkesë të datës 19.05.2023, ka kërkuar nga Komuna e Gjakovës që me mirëkuptim që të bëjë shkëputjen e kontratës për shkak të ndryshimit të sipërfaqes së shfrytëzuar të hapësirës publike.

Siç u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ me padi në Gjykatën kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

### Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- z. Gjergj Dodaj
- Arkivit.

Ardian Gjini  
Kryetar i Komunës së Gjakovës

